



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 14

2002

Maj

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 90, datë 21.3.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Lezhë-Balldre, pjesë e seksionit Lezhë-Shkodër 407
Vendim i KM nr. 93, datë 21.3.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rogozhinë-Lushnjë në territorin e qarqeve Tiranë dhe Fier 408
Vendim i KM nr. 101, datë 21.3.2002	Për një ndryshim në vendimin nr.402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjet nr. 7392, datë 17.5.1995; nr. 8286, datë 16.2.1998; nr. 8392, datë 2.9.1998; nr. 8575, datë 8.2.2000; nr. 8776, datë 24.4.2001; nr. 8852, datë 22.12.2001 dhe të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” 409
Vendim i KM nr. 103, datë 31.3.2002	Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë 409

Vendim i KM nr. 106, datë 31.3.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme, e cila preket nga ndërtimi i Urës së Mulletit dhe bashkimin e saj me rrugën ekzistuese në fshatin Mullet në qarkun e Tiranës	416
Vendim i KM nr. 107, datë 31.3.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Durrës-Rrogozhinë	419
Vendim i KM nr. 108, datë 31.3.2002	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimi i superstradës Vorë-Durrës, seksioni Vorë-Sukth në zonën e Maminasit .	420
Vendim i KM nr. 113, datë 31.3.2002	Për ndihmën ekonomike	420
Vendim i KM nr. 114, datë 31.3.2002	Për disa ndryshime në vendimin nr.429, datë 25.3.1996 të Këshillit të Ministrave "Për kohën e punës dhe të pushimit në sistemin e shëndetësisë"	423
Vendim i KM nr. 115, datë 31.3.2002	Për prokurimin e drejtpërdrejtë të fondeve për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve motorike të institucioneve buxhetore për përgjegjësitë ndaj palëve të treta	424
Vendim i KM nr. 118, datë 4.4.2002	Për miratimin e simbolit të shërbimit kombëtar të punësimit	424
Vendim i KM nr. 122, datë 4.4.2002	Për përdorimin e procedurës "Prokurim i drejtpërdrejtë" për përmirësimin e infrastrukturës së ujitjes e kullimit në pyje dhe kullota	427
Vendim i KM nr. 124, datë 4.4.2002	Për trajtimin e sportistëve të nivelit të lartë	430
Vendim i KM nr. 125, datë 4.4.2002	Për një ndryshim në vendimin nr.627, datë 24.12.1997 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë", ndryshuar me vendimet nr.664, datë 24.12.1999 dhe nr.535, datë 24.9.2001 të Këshillit të Ministrave	430

V E N D I M
Nr. 90, datë 21.3.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LEZHË-BALLDRE, PJESË E SEKSIONIT LEZHË-SHKODËR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Lezhë-Balldre, pjesë e seksionit Lezhë-Shkodër.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe 24 828 m² tokë/arë, 3592 m² truall, 521 m² objekte, 1 pikë karburanti, 24838 m² kulturë bujqësore (jonxhë), 956 copë dru frutorë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 59 718 112 (pesëdhjetë e nëntë milionë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekësh.
 4. Vlera e shpenimeve procedurale të jetë në shumën prej 441 000 (katërqind e dyzet e një mijë) lekësh.
 5. Fondi prej 60 159 112 (gjashtëdhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e dymbëdhjetë) lekësh për kompensimin e pronarëve të shpronësuar dhe shpenzime procedurale, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, të përballohet nga Buxheti i Shtetit i vitit 2002, në zërin "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.5.2002.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Shih tabelat A1, A2

V E N D I M
Nr. 93, datë 21.3.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR RROGOZHINË-LUSHNJË NË TERRITORIN E QARQEVE TIRANË DHE FIER

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrogozhinë-Lushnjë në territorin e qarqeve Tiranë dhe Fier.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe të

përgjithshme 122 567 m2 tokë/arë, 1820 m2 truall ndërtimi, 100 m2 ndërtesë, 94 m2 pikë servisi dhe lavazh, 70 m2 lokal shërbimi (restorant), shesh prodhim blloqesh dhe muri rrethues, me vlerë 528 368 lekë, 1573 m2 kulturë bujqësore. Vlera e përgjithshme për këtë shpronësim të jetë në shumën prej 101 897 074 (njëqind e një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekësh.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 1 156 600 (një milion e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind) lekësh.

5. Fondi prej 101 897 074 (njëqind e një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekësh për kompensimin e pronarëve të shpronësuar dhe shpenzimet procedurale, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, të përballohen nga Buxheti i Shtetit i vitit 2002 në zërin "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.5.2002.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

Shih tabelat B1, B2, B3, B4, B5, B6, B7

V E N D I M

Nr. 101, datë 21.3.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.402, DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJET NR. 7392, DATË 17.5.1995; NR. 8286, DATË 16.2.1998; NR. 8392, DATË 2.9.1998; NR. 8575, DATË 8.2.2000; NR. 8776, DATË 24.4.2001; NR. 8852, DATË 22.12.2001 DHE TË LIGJIT NR. 7870, DATË 13.10.1994 "PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 10 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 2 të kapitullit III të vendimit nr. 402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave bëhet ky ndryshim:

Shprehja "25 188 lekë" zëvendësohet me shprehjen "41 980 lekë".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15.1.2002.

KRYEMINISTRI

Pandeli Majko

V E N D I M

Nr. 103, datë 31.3.2002

PËR MONITORIMIN E MJEDISIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 52 të ligjit nr.7664, datë 21.1.1993 "Për mbrojtjen e mjedisit", ndryshuar me ligjin nr.8364, datë 2.7.1998, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

KREU I A. TË PËRGJITHSHME

1. Në kuptim të këtij vendimi:

- “Treguesi mjedisor” është ndryshorja që jep, në mënyrë të përmbledhur dhe të thjeshtë, të dhëna për një dukuri mjedisore, duke e bërë atë të perceptueshme nëpërmjet dhënies së një vlere numerike, matjes dhe komunikimit. Dukuritë mjedisore lidhen me cilësitë e mjedisit e të përbërësve të tij, shkarkimet në mjedis, ndotjen e mjedisit e dëmtimin e tij, biodiversitetin dhe shkallën e dëmtimit apo të ruajtjes së tij, masat e marra për mbrojtjen e mjedisit.

- “Treguesi mjedisor i gjendjes” është treguesi që ka të bëjë me cilësinë dhe sasinë e burimeve natyrore dhe cilësinë e mjedisit.

- “Treguesi mjedisor i trysnisë” është treguesi që ka të bëjë me trysninë që ushtrohet në mjedis nga burimet e ndotjes.

- “Monitorimi i mjedisit” është programi i matjeve sistematike, vëzhgimit dhe raportimit të treguesve mjedisorë.

- “Raporti i gjendjes së mjedisit” është dokumenti i përgatitur nga Ministria e Mjedisit, i cili përgatitet çdo dy vjet, ku paraqiten, komentohen dhe analizohen treguesit mjedisorë dhe jepen rekomandime për përmirësimin e gjendjes së mjedisit.

- “Të dhënat për mjedisin” janë vlerat mesatare mujore, tremujore dhe vjetore të treguesve mjedisorë të gjendjes, ndikimit dhe trysnisë.

B. Treguesit mjedisorë të gjendjes së mjedisit janë:

1. Për dukurinë e ndryshimeve klimatike:

- a) temperatura mesatare e ajrit;
- b) niveli i detit;
- c) sasia e rreshjeve atmosferike;
- ç) niveli i ujërave nëntokësore.

2. Për precipitimet atmosferike:

- a) përmbajtja e dioksidit të squfurit, SO₂;
- b) përmbajtja e oksideve të azotit, NO_x;
- c) përmbajtja e plumbit, Pb;
- ç) radioaktiviteti në precipitimet atmosferike.

3. Për ajrin urban:

- a) përmbajtja e lëndës së ngurtë, të pezullt në ajër;
- b) përmbajtja e ozonit, O₃, në ajër;
- c) përmbajtja e plumbit, Pb, në ajër;
- ç) përmbajtja e dioksidit të squfurit SO₂, në ajër;
- d) përmbajtja e oksideve të azotit, NO_x, në ajër;
- dh) përmbajtja e monoksidimit të karbonit, CO në ajër;
- e) përmbajtja e hidrokarbureve në ajër;
- ë) niveli i zhurmave;
- f) radioaktiviteti në atmosferë;
- g) rrezatimi elektromagnetik jojonizues në atmosferë;

4. Për ujërat:

4.1. Për ujërat sipërfaqësorë (lumenjtë, liqenet):

- a) alkaliniteti;
- b) konduktiviteti specifik;
- c) aciditeti;
- ç) përmbajtja e nevojës kimike për oksigjen, NKO;
- d) përmbajtja e nevojës biokimike për oksigjen, NBO;
- dh) përmbajtja e nitrateve dhe azotit;
- e) përmbajtja e fosforit, P;
- ë) përmbajtja e amoniakut, NH₃;
- f) vlera e pH-së;

- g) vlera e fonit radioaktiv natyror dhe radioaktiviteti i ujërave;
 - gj) qëndrueshmëria e shtretërve të lumenjve;
 - h) treguesit bakterialë;
 - i) prurja e lumenjve.
- 4.2. Për detin dhe bregdetin:
- a) nevoja biokimike për oksigjen për ujërat detare, NBO;
 - b) nevoja kimike për oksigjen për ujërat detare, NKO;
 - c) parametrat mikrobiologjikë për ujërat detare dhe plazhet;
 - ç) sasia e fito e zoo planktonit;
 - d) përmbajtja e klorofilit dhe prodhimtarisë primare;
 - dh) përmbajtja në midhje e ujërave detare të metaleve të rënda, ndotësve organikë të qëndrueshëm, radioaktivitetit;
 - e) radioaktiviteti i ujërave;
 - ë) ujëkëmbimi det-lagunë;
 - f) dinamika e deltave të lumenjve;
 - g) morfologjia dhe topografia e shelfit detar;
 - gj) morfologjia e bregdetit.
- 4.3. Për ujërat nëntokësorë:
- a) pH;
 - b) fortësia;
 - c) alkaliniteti;
 - c) aciditeti;
 - d) përmbajtja e nitrateve;
 - dh) shkalla e kripshmërisë.
- 4.4. Për ujërat sipërfaqësorë, nëntokësorë, detarë ku ka burime të fuqishme të ndotjes industriale dhe bujqësore:
- a) përmbajtja e metaleve të rënda;
 - b) përmbajtja e pesticideve;
 - c) përmbajtja e komponimeve hidrokarburike.
5. Për biodiversitetin: a) diversiteti gjenetik për bujqësinë dhe blegtorinë;
- b) diversiteti i ekosistemeve e habitateve;
 - c) diversiteti i ekosistemeve e habitateve në pyje;
 - ç) diversiteti i ekosistemeve e habitateve në zonat e mbrojtura;
 - d) diversiteti i ekosistemeve e habitateve në ujëra.
- 1.1. Për tokën:
- a) pjelloria;
 - b) përmbajtja e kripërave, Na, Cl, SO₄, - për tokat e kripura; përmbajtja e elementëve ushqimorë - në tokat torfike; raporti magnez/kalcium – në tokat magneziale; përcaktimi i aciditetit – në tokat acide;
 - c) radioaktiviteti natyror i tokës.
- 1.2. Ku ka burime të fuqishme të ndotjes industriale:
- a) përmbajtja e metaleve, sipas specifikave të zonës (mërkur, nikel, krom, etj);
 - b) përmbajtja e hidrokarbureve.
2. Për ujërat për ujitje:
- a) fortësia;
 - b) alkaliniteti;
 - c) aciditeti;
 - ç) përmbajtja e pesticideve;
 - d) përmbajtja e azotit dhe nitrateve.
- C. Treguesit mjedisorë të ndikimit në mjedis janë:
1. Për dukurinë e ndryshimeve klimatike:
- a) prirja e ndryshimeve në kohë për të gjithë treguesit B1;
 - b) ndryshime fenologjike.
2. Për dukurinë e aciditetit të mjedisit:

- a) përmbajtja e joneve sulfate në liqene.
- 3. Për ujërat sipërfaqësorë:
 - a) cilësia dhe sasia e prurjeve të ngurta, pezull dhe fundore të lumenjve;
 - b) erozioni i shkaktuar nga lumenjtë;
 - c) qëndrueshmëria e shtretërve të lumenjve;
 - ç) tejkalimet e normave të cilësisë së treguesve të pikës B4.1.
- 4. Për cilësinë e detit dhe të bregdetit:
 - a) lëvizja e vijës bregore: erozioni dhe akumulimi;
 - b) ujëkëmbimi det-lagunë;
 - c) dinamika e deltave të lumenjve;
 - ç) shkalla e ekspozimit të popullsisë ndaj ndotjes, mikrobiologjike dhe kimike, të plazheve dhe detit;
 - d) tejkalimet e normave të cilësisë së treguesve të pikës B4.2.
- 5. Për ujërat nëntokësorë:
 - a) zonat me kripshmëri të lartë;
 - b) zonat e ndjeshme ndaj ndotjes në vëllim;
 - c) shkalla e ekspozimit të popullsisë ndaj ujërave nëntokësorë të ndotura;
 - ç) tejkalimet e normave të cilësisë së treguesve të pikës B4.3.
- 6. Për biodiversitetin:
 - a) sipërfaqja e përgjithshme dhe vjetore e pyjeve të shkatërruara;
 - b) sipërfaqja e përgjithshme dhe vjetore e pyjeve të djegura;
 - c) sipërfaqja e përgjithshme dhe vjetore e pyjeve të sëmura;
 - ç) speciet e rrezikuara;
 - d) speciet e kërcënuara;
 - dh) speciet e zhdukura;
 - e) ndikimet antropogjene dhe të dukurive gjeologjike në diversitetin biologjik.
- 7. Për tokën dhe ujërat për vaditje:
 - a) vlera e erozionit dhe akumulimit të tokës;
 - b) humbja vjetore e tokës, si pasojë e gërryerjeve nga lumenjtë dhe shkarjet;
 - c) sipërfaqja e tokës së degraduar;
 - ç) sipërfaqja e tokës së djerrë;
 - d) sipërfaqja dhe lokalizimi i tokave të ndotura me metale të rënda;
 - dh) sipërfaqja dhe lokalizimi i tokave të ndotura me hidrokarbure;
 - e) sipërfaqja dhe lokalizimi i tokave të ndotura me kimikate dhe mbetje të rrezikshme;
 - ë) shkalla e ekspozimit të popullsisë ndaj ndotjes së tokës;
 - f) tejkalimet e normave të cilësisë së treguesve të pikës B 6.1 dhe B7.
- Ç. Treguesit mjedisorë të tryknisë në mjedis janë:
 - 1. Për ndryshimet klimatike:
 - a) sasia vjetore e shkarkimit të CO₂, NO_x dhe CH₄;
 - b) shpërndarja e shkarkimeve të CO₂, NO_x dhe CH₄ për sektorë të ndryshëm të ekonomisë, si energji, transport, administrim i mbetjeve, bujqësi, industri.
 - 2. Për ajrin urban:
 - a) sasitë vjetore të shkarkimeve në qendrat urbane të SO₂, NO_x, CO₂, CO;
 - b) shpërndarja e shkarkimeve të SO₂ e NO_x, sipas sektorëve të ekonomisë;
 - c) sasia vjetore e elementëve të rëndë;
 - ç) sasia vjetore e radioaktivitetit të precipitimeve atmosferike;
 - d) vëllimi vjetor i precipitimeve.
 - 3. Për hedhurinat e ngurta urbane:
 - a) sasitë vjetore të prodhimit;
 - b) shpërndarja e mbetjeve sipas bashkive dhe qarqeve;
 - c) përmbajtja në përqindje e përbërësve ndotës;
 - ç) përbërja merceologjike.
 - 4. Për shkarkimet e lëngta urbane:
 - a) sasia vjetore e shkaktuar dhe shpërndarja, sipas bashkive dhe qarqeve;
 - b) cilësia e tyre si pH, përmbajtja e NKO-së, përmbajtja e NBO5-së, alkaliniteti, aciditeti,

përmbajtja e sulfureve, përmbajtja e amoniakut, përmbajtja e fenoleve, përmbajtja e fosforit, përmbajtja e azotit dhe metaleve të rënda.

5. Për shkarkimet e ngurta, industriale dhe inerte:

- a) sasi të vjetore të shkarkimeve të ngurta, industriale në përgjithësi;
- b) sasi të vjetore të shkarkimeve të ngurta, industriale, për çdo impiant;
- c) përmbajtja në përqindje e përbërësve ndotës për çdo shkarkim të ngurtë, industrial;
- ç) shpërndarja e shkarkimeve vjetore të ngurta industriale për sektorë të ndryshëm të ekonomisë, energjia, transporti, industria;
- d) vëllimi i mbeturinave inerte të sektorit të ndërtimit dhe shpërndarja e tyre, sipas bashkive dhe qarqeve.

6. Për shkarkimeve e lëngta industriale:

- a) sasia vjetore e shkarkuar, pH;
- b) përmbajtja e NKO-së, përmbajtja e NBO5-së, alkaliniteti, aciditeti, përmbajtja e sulfureve, e amoniakut, e fenoleve, e fosforit, e azotit;
- c) përmbajtja e përbërësve specifikë në përputhje me specifikat si metalet e rënda, hidrokarburet, BTEX, ndotës organikë të qëndrueshëm, në varësi të procesit industrial.

7. Për burimet e ndotjes që shkarkojnë në ajër:

- a) inventari i tyre, sasia vjetore e shkarkimit të CO₂, NO_x, CH₄, NH₃, SO₂, shkalla e errësisë së tymit, komponimet organike, volatile, dioksina, furani, metalet e rënda, në përgjithësi;
- b) shpërndarja sektoriale e shkronjës “a” për sektorët e industrisë, energjisë, transportit dhe shërbimeve.

8. Sasia vjetore e kimikateve të rrezikshme, të importuara.

9. Sasia vjetore e plehrave kimike dhe e kimikateve për përdorim bujqësor.

10. Për ujërat sipërfaqësorë:

- a) cilësia dhe sasia e prurjeve të ngurta, pezull dhe fundore të lumenjve.

11. Për ujërat nëntokësorë:

- a) vëllimi vjetor i shfrytëzimit, në përgjithësi, dhe sipas baseneve;
- b) koeficienti vjetor i shfrytëzimit, në përgjithësi, dhe sipas baseneve.

KREU II

PROGRAMI KOMBËTAR I MONITORIMIT TË MJEDISIT

1. Programi kombëtar i monitorimit të mjedisit përmban përcaktimin e treguesve kryesorë të gjendjes, ndikimit dhe trysnisë në ajër, në ujëra të brendshme, në tokë, në zonën bregdetare, detet, pyjet e në larminë biologjike.

2. Programi kombëtar i monitorimit përmban, për secilin tregues mjedisor që matet apo llogaritet, emrin e tij, mënyrën e përcaktimit, metodën e matjes, metodën dhe vendin e marrjes së mostrës, shpeshësinë e matjes, njësinë e matjes, mënyrën e përpunimit dhe të paraqitjes së të dhënave.

3. Në mbështetje të programit kombëtar të monitorimit të mjedisit, të hartohet, në bashkëpunim me Institutin e Statistikës, sistemi i treguesve dhe modularëve statiskorë, unikë dhe të detyrueshëm, të mjedisit, që do të paraqesin në Ministrinë e Mjedisit të gjitha institucionet zbatuese dhe personat, fizikë e juridikë, vendas e të huaj, në zbatim të ligjit nr.7687, datë 16.3.1993 “Për statistikën”.

4. Në mbështetje të programit kombëtar të monitorimit të mjedisit, institucionet zbatuese të hartojnë projekte të posaçme për monitorimin, në përputhje me detyrat e tyre funksionale dhe bazën materiale e laboratorike përkatëse.

5. Personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, veprimtaria e të cilëve pajiset me leje mjedisore, të zbatojnë programe monitorimi të treguesve mjedisorë të trysnisë për burime individuale, të lëvizshme dhe të palëvizshme, si dhe të dokumentojnë të dhënat përkatëse, sipas modeleve të miratuara nga Ministria e Mjedisit.

6. Metodikat për matjen dhe llogaritjen e të gjithë treguesve mjedisorë janë në përputhje me standardet teknike në Republikën e Shqipërisë dhe, në rast se këto mungojnë, kërkohet miratimi i Ministrisë së Mjedisit për përdorimin e tyre.

KREU III

ZBATIMI I PROGRAMIT KOMBËTAR TË MONITORIMIT TË MJEDISIT

A. Detyrat e organeve qendrore, të institucioneve dhe personave fizikë dhe juridikë

1. Ministria e Mjedisit harton Programin kombëtar të monitorimit të mjedisit dhe bashkërendon punën për zbatimin e tij. Mbi këtë bazë Akademia e Shkencave, ministritë e përfshira në këtë vendim dhe institutet në varësi të tyre hartojnë projekte të veçanta për monitorimin e mjedisit.

2. Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik dhe drejtorive të shërbimit parësor shëndetësor, në rrethe, ngarkohet me monitorimin e treguesve, sipas pikave B3-a,b,c,ç,d,e,ë,f; B4-h; B4.2-c, C4-ç, C5-c, C7-ë, Ç4-b, Ç3-c, ç.

3. Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe qeverisja vendore ngarkohen në monitorimin e treguesve sipas pikave Ç3-a,b; Ç4-a dhe Ç5-d.

4. Akademia e Shkencave ngarkohet nëpërmjet:

a) Institutit të Hidrometeorologjisë me monitorimin e treguesve, sipas pikave: B1-a,b,c,ç; B2-a,b,c; B3-a,ç,dh; B4.1-a,b,c,ç,d,dh,e,ë,f,g,gj; B4.2-a,b,ë,f,g,gj; B4.4-a,b,c; C1-a,b; C2; C3-a,b,c,ç; C4-a,b,c,d; Ç10;

b) Institutit të Fizikës Bërthamore me monitorimin e treguesve, sipas pikave: B2-ç; B3-e,f; B4-1-g; B4.2-dh,e; B6.1-c; B3-c.

c) Institutit të Kërkimeve Biologjike me monitorimin e treguesve, sipas pikave: B5; B4.2-ç,d dhe C6-ç,d,dh,e.

ç) Qendrës së Kërkimeve Hidraulike, nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet përkatëse, për përgatitjen e raporteve të treguesve mjedisorë, sipas pikave B4.1-gj; B4.2-ë,f,g,gj; C3-a,b,c; C4-a,b,c; Ç10.

d) Qendrës së Studimeve Gjeografike për hartografinë e të dhënave të monitorimit, sipas sistemit gjeografik të të dhënave.

5. Fakulteti e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës ngarkohet me monitorimin e treguesve sipas pikave B4.4-a,b,c; B4.2-dh.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave, Instituti i Kërkimeve Pyjore, Kopshti Botanik dhe Muzeu i Fakultetit të Shkencave të Natyrës ngarkohen me monitorimin e treguesve B5 dhe C6-a,b,c,ç,d,dh,e.

7. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, nëpërmjet Institutit të Tokave, ngarkohet me monitorimin e treguesve B6, B7, C7, Ç9, si dhe Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç10 për të gjithë personat, fizikë dhe juridikë, me pronësi publike brenda sistemit të saj. Nëpërmjet Institutit të Kërkimeve Veterinare bashkëpunon me Fakultetin e Shkencave e Natyrës për treguesit, sipas pikës B4.2-dh.

8. Ministria e Industrisë dhe Energjitikës monitoron nëpërmjet:

- Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, pikat B1-ç; C3-a,b,c; B4.2-g,gj; B4.3-a,b,c,ç,d,dh; B3-f.B4.1-gj. B4.4-a,b,c; C4 – a,b,c; C5; C6-e; Ç11;

- rrjetit të instituteve në varësi të saj për të gjithë personat, fizikë e juridikë, me pronësi publike brenda sistemit të saj treguesit Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7 dhe Ç8.

9. Ministria e Mbrojtjes ngarkohet me monitorimin e treguesve sipas pikave Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8, për të gjithë personat, fizikë e juridikë, pronësi brenda sistemit të saj.

10. Personat fizikë dhe juridikë monitorojnë treguesit mjedisorë sipas pikave Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 në nivel individual.

11. Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, përgjigjet dhe teston nivelin e treguesve mjedisorë të trysnisë në ajër, Ç2 kreu I.

12. Ministria e Mjedisit përgjigjet për përpunimin dhe regjistrimin e treguesve mjedisorë, sipas pikave Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, në mbështetje të të dhënave të grumbulluara.

13. Ministria e Mjedisit ngarkohet të organizojë kontrollin e cilësisë së analizave të kryera për monitorimin e mjedisit, si dhe standardizimin e metodologjisë së tyre.

B. Shkëmbimi i të dhënave

1. Institucionet zbatuese të programit kombëtar të monitorimit të mjedisit të dorëzojnë të dhënat e përcaktuara në kontratën përkatëse në Ministrinë e Mjedisit, të paktën një herë në tre muaj, brenda datës 15 të muajit të parë të periudhës tremujore pasardhëse, si edhe sa herë që Ministria e Mjedisit ua kërkon zyrtarisht për arsye urgjente.

2. Personat, fizikë dhe juridikë, që janë subjekte të lejes mjedisore, të dërgojnë në agjencitë rajonale të mjedisit (ARM), të dhënat e monitorimit të paktën 4 herë në vit, si edhe t'i vënë në dispozicion të inspektorëve të mjedisit, gjatë inspektimit të ushtruar prej tyre. Treguesit e monitoruar nga institucionet e Akademisë së Shkencave dhe Instituti i Shëndetit Publik përjashtohen nga detyrimi për të dërguar në ARM të dhënat e monitorimit.

3. Ministritë e përfshira në programin kombëtar të monitorimit të mjedisit, sipas këtij vendimi, dhe Akademia e Shkencave të dorëzojnë në Ministrinë e Mjedisit raporte vjetore për gjendjen e mjedisit, politikat mjedisore sektoriale, të dhëna për projekte mjedisore dhe për komponentë mjedisore në projekte të ndryshme, brenda sistemeve të tyre.

4. Ministria e Mjedisit kryen inventarizimin e burimeve të ndotjes, karakteristikat e tyre dhe shpërndarjen sektoriale. Inventarizimi i burimeve të ndotjes dhe shpërndarja sektoriale rregullohen me aktnormativ të veçantë.

5. Ministria e Mjedisit raporton për treguesit mjedisore, në mbështetje të metodologjive bashkëkohore, në Këshillin e Ministrave dhe në organe të specializuara ndërkombëtare.

6. Ministria e Mjedisit përgatit dhe boton, me të dhënat e siguruara nga monitorimi i mjedisit, çdo dy vjet raportin për gjendjen e mjedisit, të cilin ia paraqet Këshillit të Ministrave, si dhe përmbush të gjitha detyrimet shtetërore, ndërkombëtare, të raportimit për gjendjen e mjedisit.

7. Ministria e Mjedisit shkëmben të dhëna të ndërsjella me Institutin e Statistikave në çdo fillim viti kalendarik, sipas një akti normativ të veçantë.

8. Ministria e Mjedisit shkëmben të dhëna të ndërsjella me këshillat e rregullimit të territorit, Sekretariatit Teknik të Ujërave, në fushën e monitorimit të rezervave ujore.

9. Ministria e Mjedisit njeh, ruan e respekton të drejtën e autorit që institucionet monitoruese kanë mbi tërë të dhënat që sigurohen nga zbatimi i programit të monitorimit të mjedisit dhe që i vihet asaj në dispozicion.

10. Ministria e Mjedisit i siguron të dhënat, në kuadër të programit kombëtar të monitorimit të mjedisit, nëpërmjet raporteve teknike, të përgatitura nga institucionet përgjegjëse, të përcaktuara në këtë vendim.

11. Të dhënat e mjedisit regjistrohen çdo tre muaj në regjistrat përkatës në Ministrinë e Mjedisit dhe hidhen në bazën elektronike të të dhënave. Regjistrat dhe baza e të dhënave janë të hapura për publikun, vendas e të huaj.

12. Institutet zbatuese të programit të monitorimit krijojnë bazën elektronike të të dhënave e të treguesve të monitorimit të mjedisit, sipas përkufizimit të tyre në këtë vendim, që duhet të jetë e hapur për publikun.

C. Të ndryshme dhe përfundimtare

1. Shpenzimet operative të monitorimit të treguesve të gjendjes dhe të ndikimit të mjedisit për përpunimin e të gjithë treguesve mjedisore, si dhe për kontrollin e saktësisë së tyre përballohen me fonde nga Buxheti i Shtetit që administrohen nga Ministria e Mjedisit.

2. Shpenzimet e monitorimit të treguesve të trysnisë për impiantet në pronësi publike përballohen nga ministritë përkatëse.

3. Fondet për monitorimin e mjedisit planifikohen si zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Mjedisit, të ministrive, sipas pikës C2, Akademisë së Shkencave dhe instituteve zbatuese të programit të monitorimit.

4. Për administrimin e fondit të saj për monitorimin, Ministria e Mjedisit hyn në marrëdhënie kontraktore me institutet e ngarkuara për monitorimin dhe, kur e shih të nevojshme, edhe me institucione të tjera, në mbështetje të projekteve të paraqitura.

5. Personat, fizikë dhe juridikë, që janë subjekt i lejes mjedisore, i përballojnë vetë shpenzimet e monitorimit të mjedisit.

6. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, ministritë, institucionet qendrore dhe Akademia e Shkencave për hartimin e rregulloreve dhe të udhëzimeve përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi nr. 541, datë 25.9.1995 i Këshillit të Ministrave "Për detyrat që kanë ministritë, personat, fizikë e juridikë për monitorimin e mjedisit" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 106, datë 31.3.2002

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURISË SË PALUAJTSHME, E CILA
PREKET NGA NDËRTIMI I URËS SË MULLETIT DHE BASHKIMIN E SAJ ME RRUGËN
EKZISTUESE NË FSHATIN MULLET NË QARKUN E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimi për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarit, i cili preket nga ndërtimi i Urës së Mulletit, dhe bashkimin e saj me rrugën ekzistuese në fshatin Mullet, në Qarkun e Tiranës.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.
 3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 210 m² tokë/ arë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 210 000 (dyqind e dhjetë mijë) lekësh.
 4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 28 000 (njëzet e tetë mijë) lekësh.
 5. Fondi prej 238 000 (dyqind e tridhjet e tetë mijë) lekësh, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, të përballohet nga Buxheti i Shtetit i vitit 2002 në zërin "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.5.2002.
 7. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Prefektura e Qarkut të Tiranës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Republika e shqipërisë
qarku: tiranë
fshati: mullet

lista e personave që shpronësohen si rezultat i ndërtimit të urës së mulletit dhe rakordimit me rrugën ekzistuese me fshatin mullet

Lloji i pasurisë së paluajtshme: tokë bujqësore

		Pronar		Nr. pas	Tokë bujqësore		Vlera totale
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri		m ²	Lekë/m ²	
1	Hysen	Fadil	Haxhiu	208/1	210	1000	210000

Mbyllet me numër rendor 1.
Shpenzime procedurale për publikimet 28 000 lekë.
Vlera totale për shpronësim 238 000 lekë.

V E N D I M
Nr. 107, datë 31.3.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR DURRËS-RRGOZHINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Durrës-Rrogozhinë, (lidhja By-pass e Kavajës me rrugët hyrëse Kavajë).
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqet 883 m² tokë/arë, 500 m² truall, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 2 209 600 (dy milionë e dyqind e nëntë mijë e gjashtëqind) lekësh.
4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 200 200 (dyqind mijë e dyqind) lekësh.
5. Fondi prej 2 409 800 (dy milionë e katërqind e nëntë mijë e tetëqind) lekësh, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, të përballohet nga Buxheti i Shtetit i vitit 2002 në zërin "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.
6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.5.2002.
7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMNISTRI
Pandeli Majko

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

LISTA E PERSONAVE QË SHPRONËSOHEN

Nr.	Pronar			Nr.parc.	Nr.z. kadas	Truall			Tokë bujqësore			Totali	Shënim
	Emri	Atësia	Mbiemri			M2	Lekë/m2	Lekë	m2	Lekë/m2	Lekë		
1	Osman	Alush	Hoxha	17/88	3817				230	1200	276000	276000	
2	Bedri	Rrapush	Hoxha	17/89	3817				225	1200	270000	270000	
3	Rrapush	Alush	Hoxha	17/90	3817				78	1200	93600	93600	
4	Bajram	Alush	Hoxha	17/91	3817				110	1200	132000	132000	
5	Bilal	Alush	Hoxha	17/92	3817				51	1200	61200	61200	
6	Irfan	Selim	Hoxha	17/93	3817				23	1200	27600	27600	
7	Fatmir	Selim	Hoxha	17/94	3817				43	1200	51600	51600	
8	Rustem	Jakup	Hoxha	17/95	3817				45	1200	54000	54000	
9	Kujtim	Rustem	Hoxha	17/96	3817				28	1200	33600	33600	
10	Kasem		Hoxha						25	1200	30000	30000	
11	Hekuran	Kasem	Hoxha						25	1200	30000	30000	
12	Bashkëpronarët Biturku			94/6 1/12	3101	125	2300	287500				287500	
13	Kastriot	Ramadan	Llakaj	1/11	3101	375	2300	862500				862500	

	Shuma					500	2300	1150000	883	1200	1059600	2209600	
--	-------	--	--	--	--	-----	------	---------	-----	------	---------	---------	--

Mbyllet me numër rendor 13.

Shpenzime procedurale për publikimet 200 200 lekë.

Vlera totale për shpronësimin 2 409 800 lekë.

KRYETARI I KOMISIONIT

DREJTORE

Sadetin Stankaj

Miranda Shuli

V E N D I M
Nr. 108, datë 31.3.2002

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SUPERSTRADËS VORË-DURRËS, SEKSIONI VORË-SUKTH NË ZONËN E MAMINASIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 " Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i superstradës Vorë-Durrës, seksioni Vorë-Sukth në zonën e Maminasit.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqet 5862 m² tokë/arë, 1500 m² truall, 70 rrënjë dru frutorë, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 11 997 580 (njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekësh.
4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 330 000 (treqind e tridhjetë mijë) lekësh.
5. Fondi prej 12 327 580 (dymbëdhjetë milionë e treqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekësh, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, të përballohet nga Buxheti i Shtetit i vitit 2002 në zërin "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.
6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.5.2002.
7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Shih tabelat C1, C2.

V E N D I M
Nr. 113, datë 31.3.2002

PËR NDIHMËN EKONOMIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 pika 3 dhe 37 të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror", me ndryshimet përkatëse, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Familjet, që pretendojnë për ndihmë ekonomike, duhet të paraqesin pranë seksioneve të ndihmës dhe përkujdesit shoqëror pranë bashkisë apo komunës ku kanë vendbanimin këto dokumente:

a) deklaratën "tip" për gjendjen shoqërore-ekonomike të familjes, e cila plotësohet nga kryefamiljari një herë në vit;

b) deklaratën specifike "tip", që plotësohet, detyrimisht, çdo muaj;

c) certifikatën e gjendjes familjare, ku shënohet data e regjistrimit në regjistrin themeltar dhe vendbanimi i mëparshëm;

ç) dokumentin e pronësisë të lëshuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (kadastra) për tokat bujqësore, duke shënuar sipërfaqen dhe kategorinë e tokës.

Deklaratat "tip" përgatiten sipas modeleve të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

2. Administratorët e zyrave të ndihmës ekonomike, në bashki ose komuna, janë të detyruar të marrin zyrtarisht, nëpërmjet listave, të dhënat e nevojshme nga institucionet e mëposhtme:

- zyra e punës,

- zyra e tatim-taksave,

- zyra e sigurimeve shoqërore,

- zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme (hipoteka),

- zyra e regjistrimit të automjeteve,

- seksioni pranë bashkive (urbanistika, tregu i lirë),

- Inspektorati Shtetëror i Punës.

a) Këto institucione dhe, sipas rastit, edhe institucionet e tjera janë të detyruara që, brenda 10 ditëve nga marrja e listave, të njoftojnë, zyrtarisht, zyrat e ndihmës ekonomike në bashki a komuna.

b) Administratorët shoqërorë kanë të drejtë kur paraqitet nevoja, të marrin të dhëna nga këto institucione.

c) Institucionet e mësipërme janë të detyruara të njoftojnë çdo muaj, zyrtarisht, administratorët e zyrave të ndihmës ekonomike, në bashki a komuna, për të gjitha ndryshimet që ndodhin në njësitë e tyre përkatëse.

3. Në rastet kur familja përfituese rikthehet në skemën e ndihmës ekonomike, pas një periudhe ndërprerjeje të pagesës deri në një muaj, ajo duhet të riplotësojë dokumentacionin e plotë.

4. Për kushte të veçanta shoqërore-ekonomike dhe shëndetësore të familjes, administratorët shoqërorë duhet të kërkojnë dokumente shtesë, plotësuese, të cilat përcaktohen me udhëzimin e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale.

5. Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës familjet që kanë në përbërje qoftë edhe një anëtar që të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Është pronar i çdo lloj kapitali, me përjashtim të shtëpisë së banimit dhe tokës bujqësore;

b) është ekonomikisht aktiv (punëdhënës, i punësuar ose i vetëpunësuar); Përjashtohen invalidët e punës, të verbrit, të paaftët paraplegjikët dhe tetraplegjikët.

c) është jashtë shtetit për çdo arsye, me përjashtim të studimit ose kurimit (e vërtetuar kjo me dokumentacionin përkatës);

ç) nuk është i regjistruar si punëkërkuar i papunë; Përjashtohen anëtarët e familjeve bujqësore, invalidët e punës, të paaftët, paraplegjikët dhe tetraplegjikët.

d) kundërshton pjesëmarrjen në punë dhe në formimin profesional, kur është i aftë dhe në moshë për punë;

dh) nuk ka pranuar të marrë tokën që i takonte sipas ligjit;

e) nuk ka paguar kontributet e sigurimeve shoqërore kur ka qenë në marrëdhënie pune;

ë) nuk tërheq nga banka ndihmën ekonomike të dhënë, brenda 10 ditëve nga data e tërheqjes, me përjashtim të rasteve të fatkeqësive, sëmundjeve të vërtetuara me dokumente;

f) vihet re që ndërmerr veprime të qëllimshme për të përfutur ndihmën ekonomike; Në këto veprime përfshihen:

- shmangie nga punësimi dhe formimi profesional;

- dhurim spekulativ i kapitaleve;

- ndarje spekulative e një ose disa anëtarëve të familjes.

g) braktis dhe nuk shfrytëzon pronat dhe burimet e tjera të jetesës;

gj) nuk pranon verifikimin, intervistimin në zyrë ose në shtëpi nga administratori shoqëror;

h) ndryshon vendbanimin, me përjashtim të rasteve:

i) për arsye të detyrave ose kërkesave nga shteti;

ii) kur përbën një rast të veçantë, sipas vendimit të këshillit të bashkisë a komunës të vendbanimit të mëparshëm, ku të përcaktohet data e marrjes së vendimit, si rast i veçantë; Vendimi i organit të njësisë së qeverisjes vendore të vërtetohet nga prefektura.

iii) kur, deri në çastin e ndryshimit të lëvizjes së vendbanimit është trajtuar me ndihmë ekonomike në vendbanimin e mëparshëm dhe vazhdon të plotësojë kushtet për përfitim të ndihmës ekonomike në vendbanimin e ri sipas legjislacionit në fuqi;

iv) familjeve të invalidëve të punës, të cilët kanë ndryshuar vendbanimin, deri në çastin e daljes së këtij vendimi.

6. Kanë të drejtë të pretendojnë ndihmë ekonomike të pjesshme familjet bujqësore që, në bazë të dokumenteve, kanë tokë në pronësi ose në përdorim, duke përjashtuar familjet bujqësore që:

a) kanë përfutur tokë sipas ligjit, por që, realisht, nuk e disponojnë për shkak të zënies së tokës;

b) që kanë zënë forcërisht tokën e dikujt tjetër;

c) që nuk kanë përfutur tokë realisht, me dokumente, sepse toka nuk mund të ndahet për shkak të problemeve të ndryshme të pronësisë;

ç) kanë shitur dhe blerë tokë ose marrin dhe japin me qira tokën.

7. Trajtohen me ndihmë ekonomike të plotë familjet që:

a) kanë marrë tokë në zonat e kripura;

b) nuk kanë marrë tokë, pasi me vendim të Këshillit të Ministrave toka është cilësuar zonë urbane, e zënë me hidrocentrale, ujësjellës ose ndonjë vepër tjetër dhe vendosja e tyre të jetë e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Trajtohen me ndihmë ekonomike familjet që kanë ndryshuar vendbanimin pas vitit 1991, nga qyteti në qytet dhe në çastin e lëvizjes kanë qenë të punësuar në vendbanimin e ri.

9. Familjet, që pretendojnë ndihmë ekonomike, të cilat janë regjistruar në zyrat e gjendjes civile të bashkive pas datës 1 gusht 1991, dhe vendbanimi i mëparshëm ka qenë fshati, ndërsa vendbanimi i ri është qyteti, duhet të paraqesin edhe këto dokumente:

a) vërtetimin e nënshkruar dhe të vulosur nga kryetari i bashkisë (kur në përbërje të të cilave ka fshatra, banorët e të cilëve janë trajtuar me tokë) a i komunës, kryeplaku dhe përgjegjësi i zyrës së kadastrës, në të cilin të shprehet se familja nuk disponon tokë, as në pronësi dhe as në përdorim, sipas vendimit të komisionit të ndarjes së tokës, meqenëse është larguar nga vendbanimi para datës 1 gusht 1991, për arsye pune;

b) dokumentin që vërteton se ka qenë i punësuar që nga çasti i largimit nga vendbanimi në fshat;

c) aktin e marrjes në pronësi të tokës, në rastin kur kanë përfutur tokë; Nëse familja pretenduese është e pajisur me dokumentet "a" dhe "b" ka të drejtë të pretendojë ndihmë ekonomike të plotë, nëse është pajisur me dokumente "b" dhe "c" ka të drejtë të pretendojë ndihmë ekonomike të pjesshme. Nëse nuk paraqet njërin nga këto dokumente, familja nuk ka të drejtë të pretendojë ndihmë ekonomike.

10. Masa e ndihmës ekonomike përcaktohet nga niveli bazë i pagesës së papunësisë. Niveli më i lartë i ndihmës ekonomike të plotë, mujore, që përfiton familja, nuk mund të jetë më i madh se

250 për qind të nivelit bazë të pagesës së papunësisë.

11. Masa e ndihmës ekonomike të plotë, mujore, për familjen përbëhet nga shuma e dy pjesëve përbërëse, që janë:

a) shuma bazë, e cila i jepet vetëm kryefamiljarit dhe nuk mund të jetë më e madhe se 95 për qind e nivelit bazë të pagesës mujore të papunësisë;

b) një shtesë mbi shumën bazë, për çdo anëtar tjetër të familjes, e cila nuk mund të jetë më e madhe se:

- 100 për qind kur anëtari i familjes është mbi moshën e punës ose i paaftë, fizikisht a mendërisht:

- 20 për qind kur është në moshë pune;

- 25 për qind kur është nën moshën e punës.

12. Masa e ndihmës ekonomike mujore të pjesshme është e barabartë me diferencën ndërmjet nivelit më të lartë të ndihmës, së plotë mujore, dhe të të ardhurave aktuale të familjes, në të cilat përfshihen:

a) të ardhurat nga veprimtaria ekonomike (si i punësuar i vetëpunësuar apo punëdhënës);

b) të ardhurat nga çdo sistem i mbrojtjes shoqërore, shtetërore, private ose individuale, me përjashtim të të ardhurave që marrin invalidët e punës, të verbrit, paraplegjikët e tetraplegjikët, në mbështetje të statusit të tyre;

c) të ardhurat nga çdo lloj kapitali;

ç) të ardhurat nga toka (përveç tokës në proces shkripëzimit);

d) të ardhurat nga blegtoria dhe shpendët;

dh) të ardhurat nga vreshtat, ullishtet, agrumet, pemëtaria dhe mbajtja e bletëve.

13. Nuk përfitojnë ndihmë ekonomike familjet, të cilave, sipas llogaritjeve, u takon të marrin më pak se 500 (pesëqind) lekë në muaj. Përjashtohen nga kjo masë familjet që në përbërje të tyre kanë persona të paaftë, që kanë nevojë për kujdestar.

14. Për përfitimin e ndihmës ekonomike nuk merret parasysh ndarja e familjeve pas datës 1 korrik 1993, me përjashtim të rasteve të një martese të re.

15. Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale, në bashkëpunim me Ministrin e Bujqësisë dhe Ushqimit, të nxjerrin udhëzimin për llogaritjen e të ardhurave nga bujqësia dhe blegtoria.

16. Ngarkohen organet e administratës shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

17. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale të nxjerrë udhëzimet e nevojshme në zbatim të vendimit.

18. Vendimet nr.328, datë 30.6.1993; nr.496, datë 18.10.1993; nr.124, datë 15.3.1994; nr.208, datë 25.4.1995; nr.605, datë 30.10.1995; nr.620, datë 6.11.1995; nr.689, datë 14.10.1996; nr.216, datë 4.4.1998; nr.10, datë 14.1.1999 të Këshillit të Ministrave shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 114, datë 31.3.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.429, DATË 25.3.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR KOHËN E PUNËS DHE TË PUSHIMIT NË SISTEMIN E
SHËNDETËSISË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 81, 87 dhe 91 të ligjit nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.429, datë 25.3.1966 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"4. Çdo orë pune e kryer nga ora 19.00 deri në orën 22.00 paguhet sipas rregullave të parashikuara në nenin 81 të ligjit nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë".

2. Pika 6 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"6. Puna e kryer ditën e dielë ose në ditët e festave zyrtare kompensohet me një shtesë, sipas rregullave të parashikuara në nenin 87 të ligjit nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë".

3. Pika 7 të ndryshohet si më poshtë vijon:

"7. Për orët suplementare të punës, që nuk janë kompensuar me pushim, punëmarrësit i jepet paga normale dhe një shtesë mbi pagë, sipas rregullave të parashikuara në nenin 91 të ligjit nr.7961, datë 2.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 115, datë 31.3.2002

**PËR PROKURIMIN E DREJTPËRDREJTË TË FONDEVE PËR SIGURIMIN E
DETYRUESHËM TË MJETEVE MOTORIKE TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE PËR
PËRGJEGJËSITË NDAJ PALËVE TË TRETA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", ndryshuar me ligjin nr.8767, datë 5.4.2001, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejimin e institucioneve buxhetore, që, për fondet limit, të miratuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2002, të përdorin procedurën "Prokurim i drejtpërdrejtë" me Institutin e Sigurimeve sh.a. (INSIG) për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve të tyre motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta.

2. Primi që INSIG sh.a.-ja do të arkëtojë nga institucionet buxhetore të jetë vlera e primit të pastër, duke i shtuar vlerën e shpenzimeve minimale administrative, të përcaktuara me urdhër të Ministrit të Financave.

3. Ngarkohen institucionet buxhetore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 118, datë 4.4.2002

PËR MIRATIMIN E SIMBOLIT TË SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT


Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:


Miratimin e simbolit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit sipas konfiguracionit, i cili i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.


KRYEMINISTRI
Pandeli Majko



Logo e SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT (330x320x150 mm)



**SHËRBIMI KOMBËTAR
I PUNËSIMIT**



V E N D I M
Nr. 122, datë 4.4.2002

**PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS "PROKURIM I DREJTPËRDREJTË" PËR
PËRMIRËSIMIN E INFRASTRUKTURËS SË UJITJES E KULLIMIT NË PYJE DHE
KULLOTA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002" dhe të pikës 3 të nenit 17 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 "Për prokurimin publik", ndryshuar me ligjet përkatëse, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit që, për fondin prej 116 200 000 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e dyqind mijë) lekësh, të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë" me drejtoritë e ujërave në rrethe, për përmirësimin e infrastrukturës së ujitjes e kullimit (kanale kullimi, kanale të ujërave të larta, argjinaturë), sipas listës A, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave që, për fondin prej 96 540 000 (nëntëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e dyzetë mijë) lekësh, të përdorë procedurën "Prokurim i drejtëpërdrejtë", me drejtoritë e shërbimit pyjor në rrethe, për përmirësimin e objekteve në pyje e kullota (pyllëzime, përmirësime e cungime, sistemime malore, mirëmbajtje rrugë pyjore, punime në zonat mbrojtëse, riparime lerash dhe përmirësime kullotash), sipas listës B që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Mjko

Shih tabelën D1

A. Lista e objekteve të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit (kanaleve të kullimit, kanaleve të ujërave të larta, argjinaturave)

Tab. D1, D2, D3

Nr	Emërtimi i objektit	Volumi në m3	Çmimi në lekë	Vlera në 000 lekë
1	Rrethi Berat	35294	85	3000
	1-Kanali kullues Qendër	17647	85	1500
	2-Kanali kullues Mesi i Urave	17647	85	1500
2	Rrethi Devoll	23530	85	2000
	1-Thellimi i Lumit Devoll	23530	85	2000
3	Rrethi Durrës	123529	85	10500
	1-Sistemi kullues Pjezë-Xhafzotaj-Arapaj	29411	85	2500
	2-Sistemi kullues Sallmone e Koxhas	11765	85	1000
	3-Sistemi kullues Këneta Durrës	11765	85	1000
	4-Sistemi kullues Shkozë-Ura e Dajlanit	47058	85	4000
	5-Sistemi kullues Shënavlash – Plepa	23530	85	2000
4	Rrethi Elbasan	25885	85	2200
	1-Sistemi kullues Vidhas	11765	85	1000
	2-Sistemi kullues Dumre	14120	85	1200
5	Rrethi Fier	52941	85	4500

	1-Kanali i ujërave të larta Levan-Pojan	29411	85	2500
	2-Argjinatura K.M.U.	23530	85	2000
6	Rrethi Gjirokastrë	23530	85	2000
	1-Kanali kullues KK-1 Dropull	23530	85	2000
7	Rrethi Kavajë	82352	85	7000
	1-Sistemi kullues i hidrovorit Synej	41175	85	3500
	2-Sistemi kullues i hidrovorit Greth	17647	85	1500
	3-Sistemi kullues Fushë - Rrogozhinë	11765	85	1000
	4-Sistemi kullues Luz	11765	85	1000
8	Rrethi Korçë	94118	85	8000
	1-Thellimi dhe zgjerimi i Lumit Devoll-Maliq	47058	85	4000
	2-Kolektori i Sovjanit	23530	85	2000
	3-Kullimi i Fushës së Leshnjës	9410	85	800
	4-Kulluesat Çiflik-Bulgarec	14120	85	1200
9	Rrethi Krujë	117648	85	10000
	1-Kanali kullues KK-4 e KK-10(Thumanë)	35294	85	3000
	2-Kanali kullues KK-8; G-2 (Nikel)	23530	85	2000
	3-Kanali ujërave të larta Mazhe;KK-2; KK-10 (Bubq)	35294	85	3000
	4-Kanalet kulluese KK-8 e KK-11 (Fushë Krujë)	23530	85	2000
10	Rrethi Kuçovë	47060	85	4000
	1-Kanali kullues Distributor-Dikater	23530	85	2000
	2-Kanali kullues Rreth Tapi	23530	85	2000
11	Rrethi Kurbin	94116	85	8000
	1-Kanali ujërave të larta LAU-1	47058	85	4000
	2-Kanali kullues i dërgimit të hidrovorit Shllinzë	47058	85	4000
12	Rrethi Lezhë	129410	85	11000
	1-Thellimi dhe zgjerimi i lumit Drin (Ura e Qytetit-Balldre)	64705	85	5500
	2-Grykëderdhjet e kanalit të ujërave të larta të Zadrimës	29411	85	2500
	3-Kolektori i dërgimit të hidrovorit Balldre	35294	85	3000
13	Rrethi Lushnjë	18825	85	1600
	1-Kolektori i Gjzës	8235	85	700
	2-Kolektori Sejmenas	7060	85	600
	3-Kullimi IKB	3530	85	300
14	Rrethi Malësi e Madhe	35292	85	3000
	1-Kanali kullues Vija-Vrakë	5880	85	500
	2-Kanali kullues KK-27 Koplik	11765	85	1000
	3-Kanali kullues Gziq	17647	85	1500
15	Rrethi Peqin	70585	85	6000
	1-Kanali ujërave të larta KLU 1+2 Gjocaj -Shezë	32940	85	2800
	2-Kanali kullues KK-2 Përparim -Pajovë-Karinë	37645	85	3200
16	Rrethi Pogradec	40000	85	3400
	1-Kanali kullues Nizhavec-Veliter	14118	85	1200
	2-Kanali kullues Fushë-Blacë	11764	85	1000
	3-Kanali i ujërave të larta Baçallëk	14118	85	1200
17	Rrethi Sarandë	88236	85	7500
	1-Kanali i Komunikimit	29411	85	2500
	2-Kanali ujërave të larta Xare	23530	85	2000
	3-Kanali ujërave të larta Çukë (piketa 0-9)	11765	85	1000
	4- Kanali kullues 12 Livine	23530	85	2000
18	Rrethi Shkodër	58824	85	5000
	1-Kanali kullues Vinjar	17647	85	1500
	2-Kanali kullues KK-46 Trush	17647	85	1500

	3-Kanali kullues Trush-Ura e Gjollit	23530	85	2000
19	Rrethi Tepelenë	17645	85	1500
	1-Kullimi i Fushës së Krahësit	11765	85	1000
	2-Kullimi i Fushës së Qesaratit	5880	85	500
20	Rrethi Tiranë	35295	85	3000
	1-Sistemi kullues Prezë-Kashar-Vorë-Yzberisht	23530	85	2000
	2-Sistemi kullues Kamëz-Vaqarr-Arbanë-Baldushk	11765	85	1000
21	Rrethi Vlorë	152944	85	13000
	1-Kanali kullues Tokat e Ulta	35294	85	3000
	2-Kanali kullues Sherisht-Babicë	23530	85	2000
	3-Kanali kullues Orikum (Vallto)	23530	85	2000
	4-Kanali ujërave të larta Shkozë	11765	85	1000
	5-Kanali kullues Izvor-Tragjas	11765	85	1000
	6-Argjinatura Vallto-Dukat	23530	85	2000
	7-Argjinatura Selevec	23530	85	2000
	TOTALI	1367059	85	116200

V E N D I M
Nr. 124, datë 4.4.2002

PËR TRAJTIMIN E SPORTISTËVE TË NIVELIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 dhe 30 paragrafi i parë të ligjit nr.8114, datë 28.3.1996 "Për sportin", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Sportistët e nivelit të lartë përfitojnë trajtim ekonomik, ushqimor, në lekë ose në natyrë, deri në kuotën e 1500 (një mijë e pesëqind) lekëve në ditë, por jo më shumë se për 25 ditë në muaj.

2. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimet nr.41, datë 27.1.1997 dhe nr.666, datë 7.12.2001 të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

V E N D I M
Nr. 125, datë 4.4.2002

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.627, DATË 24.12.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME VENDIMET NR.664, DATË 24.12.1999 DHE NR.535, DATË 24.9.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pika 4 e vendimit nr.627, datë 24.12.1997 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me vendimet nr.664, datë 24.12.1999 dhe nr.535, datë 24.9.2001 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

"4. Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë ka këtë përbërje:

- | | |
|--|-----------------|
| 1. Kryeministri | kryetar |
| 2. Ministri i Rregullit të Territorit dhe Turizmit | zëvendëskryetar |
| 3. Ministri i Drejtësisë | anëtar |
| 4. Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit | anëtar |
| 5. Ministri i Industrisë dhe Energjetikës | anëtar |
| 6. Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit | anëtar |
| 7. Ministri i Ekonomisë | anëtar |
| 8. Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit | anëtar |
| 9. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | anëtar |
| 10. Ministri i Mjedisit | anëtar |
| 11. Një përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes | anëtar |
| 12. Një përfaqësues nga Akademia e Shkencave | anëtar |

Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit sekretar"

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 11. 5.2002
Doli nga shtypi më 13. 5.2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë